

Njoftim aplikimi për modifikim licence

Në zbatim të nenit 40, pika 1 e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 19, pika 1, germa ”a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe nenit 10, pika 8 dhe 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, njoftojmë se shoqëria “IDI 2005” shpk ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për modifikimin e licencës së shoqërisë “IDI 2005” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 289, datë 13.11.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 8.8 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

Në mbledhjen e datës 29.06.2026, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë.

Ftohen palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim në lidhje me kërkesën e mësipërme për modifikim, brenda 10 (dhjetë) ditëve (nga data 01.07.2026 deri më 10.07.2026) pranë zyrave të ERE-s, në adresën: në adresën: Rruga “Irfan Tomini”, Njësia Administrative Nr. 7, Tiranë, ose në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al.